



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr 31/2 Prot

Tiranë, më 30/06/2020

NJOFTIM

“Për kriteret dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë për anëtar të Senatit Akademik të Akademisë së Studimeve Albanologjike”

Kandidatët që do të aplikojnë për anëtarë të Senatit Akademik duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Nenin 18 dhe Nenin 22, pika 1 dhe 3, të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike” si dhe duhet të paraqesin pranë sekretares së KIZ, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën për kandidim, e cila përmban:
 - emrin;
 - atësinë;
 - mbiemrin;
 - datëlindjen;
 - gjininë;
- b) kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) kopje të noterizuar të titullit akademik;
- d) dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar, vendin dhe vitet e punësimit.
- e) shprehjen e vullnetit për kandidim;
- f) formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ) për:
 - deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
 - mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
 - deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
 - deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- deklarin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.
- g) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor, jo më pak se 10 (dhjetë) vjet
- h) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 (pesë) vjetësh.

KRYETAR

Hasan Bello

